

2. Palët pajtohen në mënyrë të parevokueshme që me komunikim dhe pajtim të zgjidhet çdo mosmarrëveshje apo kërkesë që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 9

Kohëzgjatja dhe ndërprerja

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit. Synohet që kushtet e kësaj Marrëveshje të mbeten në fuqi për 3 vite nga hyrja në fuqi, me mundësi vazhdimi me dakordim paraprak me shkrim.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndërpritet me një njoftim 1 muajsh në rast se lindin kushtet e mëposhtme:
 - 2.1. Është vërtetuar se njëra nga palët i shkakton vullnetarisht dëme palës tjetër;
 - 2.2. Në rast se nuk janë përmbushur obligimet e palëve;
 - 2.3. Nëse të dyja palët bien dakord reciprokisht për një ndërprerje të parakohshme të partneritetit;
 - 2.4. Në rast të ngjarjeve të forcës madhore.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj.

Marrëveshja është hartuar në tre kopje origjinale në gjuhën shqipe. Palët do të mbajnë një kopje origjinale.

Secila palë konfirmon pajtimin e saj me kushtet e përfshira në këtë Marrëveshje.

Prishtinë,

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe
Inovacionit (MASHTI)



Znj. Arbërie Nagavci
Ministre



Prof. Dr. Qerim Qerimi
Rektor

Fakulteti i Edukimit/IHZHA



Prof. Asoc. Dr. Blerim Saqipi
Dekan

3. Emëron pikën e kontaktit nga ana e MASHTI-t të cilët do të kenë përgjegjësi të komunikimit me personelin e UP/FE për të siguruar mbarëvajtjen e aktiviteteve.
4. Merr pjesë aktive në takimet të organizuara me UP/FE për të siguruar qëndrueshmërinë e realizimit të aktiviteteve të përcaktuara.
5. Aprovon programet e zhvillimit profesional të propozuara nga UP/FE sipas procedurave, kritereve dhe rregulloreve në fuqi.
6. Në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit lëshon certifikata në harmoni me kriteret dhe standardet në fuqi për programet e miratuara nga MASHTI.
7. Bën monitorimin e zbatimit të aktiviteteve për zhvillim profesional të punonjësve të arsimit parauniversitar të ofruara nga Fakulteti i Edukimit dhe të financuara nga MASHTI.
8. Përkrah financiarisht aktivitetet e dakorduara me Universitetin e Prishtinës/Fakultetin e Edukimit për zbatimin e programeve të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve dhe drejtorëve të shkollave të akredituara nga MASHTI në tematikat e cilësuara me interes për zhvillimin e shkollave dhe përmirësimin e cilësisë në arsim.
9. Mbikëqyr zbatimin e aktiviteteve të dakorduara sipas pikës 8 të këtij neni.

Neni 3 Përgjegjësitë e Fakultetit të Edukimit

1. Dizajnon dhe organizon zbatimin e programeve të zhvillimit profesional për mësimitdhënës, drejtorë të shkollave dhe profesionistë të tjerë arsimor në tematikat e cilësuara me interes për zhvillimin e institucioneve arsimore dhe përmirësimin e cilësisë në arsim.
2. Dizajnon dhe është përgjegjëse për realizimin në mënyrë të plotë të aktiviteteve të cilat lidhen me nevojat e mësimitdhënësve, drejtorëve, shkollave, DKA-ve, MASHTI-t dhe komunitetit të gjerë cilat do të shërbejnë për zhvillimin e cilësisë së mësimitdhënies, shkollës si organizatë, hartimin dhe zbatimin e politikave arsimore të bazuara në dëshmi.
3. Aktivitetet sipas pikës 3 të këtij lidhen me fushën e programeve të zhvillimit profesional që do të financohen me këtë marrëveshje. Tematikat prioritare janë të lidhura me:
 - 3.1. Reforma kurrikulare dhe të qenit mësimitdhënës;
 - 3.2. Të kuptuarit dhe zhvillimi i praktikave të mësimitdhënies në fusha të ndryshme kurrikulare
 - 3.3. Të qenit mësimitdhënës hulumtues dhe udhëheqës;
 - 3.4. Autonomia e shkollës dhe zhvillimi i kulturës organizative;
 - 3.5. Zhvillimi, edukimi dhe mirëqenia e fëmijëve dhe adoleshentëve;
 - 3.6. Tematikat e tjera me interes që mund të zhvillohen në bashkëpunim me MASHTI-n varësisht nga kapacitetet dhe resurset në dispozicion si dhe nevoja dhe kërkesat.
4. Përcakton dhe aprovon përbërjen e ekipit të projekteve hulumtuese nga ana e personelit akademik të UP/FE dhe studentëve të UP/FE si dhe cakton trajnerë të kualifikuar për të udhëhequr programet për zhvillim profesional duke ndjekur një qasje të bazuar në hulumtim.

5. Emëron pikën e kontaktit nga ana e personelit akademik të UP/FE të cilët do të kenë përgjegjësi koordinimin dhe komunikimin me shkollat për organizimin e trajnimeve tematike dhe realizimin e projekteve hulumtuese.
6. Organizon takime me MASHTI-n, DKA-të, dhe shkollat partnere për të siguruar qëndrueshmërinë e realizimit të aktiviteteve të përcaktuara.
7. Siguron materialin e programit përkatës (modulin) dhe materialet e tjera shpenzuese.
8. Përgatit të gjitha materialet dhe dokumentet e nevojshme për realizimin e hulumtimit.
9. Siguron lokacionin e organizimit të programeve për zhvillim profesional.
10. Kryen monitorimin e zbatimit të programit trajnues në bazë të një metodologjie të dakorduar me MASHTI-n.
11. Realizon vlerësime të kohëpaskohshme të nevojave të mësimdhënësve, drejtorëve, dhe punonjësve të tjerë arsimorë për zhvillim profesional duke reflektuar reformat e synuara.
12. Përgatitë koncept dokumente/propozime/raporte përmbledhëse për MASHTI-n për të informuar për një vendimmarrje të bazuar në dëshmi duke u fokusuar në temat e aktiviteteve të zhvillimit profesional të implementuara në kuadër të kësaj marrëveshje.
13. Organizon konferenca, punëtori, dhe takime të tjera me pjesëmarrjen e akterëve relevant për të prezantuar rezultatet e dala nga projektet hulumtuese.
14. Në bashkëpunim me MASHTI-n do të kryhen certifikimet e pjesëmarrësve në programet e zhvillimit profesional.
15. Të sigurojë gjithpërfshirje, transparencë dhe vizibilitet në aktivitetet e planifikuara.
16. Sigurohet falas pjesëmarrja në aktivitetet e planifikuara dhe dakorduar me MASHTI-n për mësimdhënës, drejtorë të shkollave dhe profesionistë të tjerë arsimor në tematikat e cilësuara me interes për zhvillimin e institucioneve arsimore dhe përmirësimin e cilësisë në arsim.
17. Përgatit dhe dorëzon raport të detajuar për realizimin e aktiviteteve në Rektoratin e UP-së dhe MASHTI-t së paku një herë në vit.

Neni 4

Implementimi, afatet kohore dhe dinamika

1. Kjo marrëveshje rregullon bashkëpunimin midis dy institucioneve. Në baza vjetore, të dy institucionet definojnë detajet e aktiviteteve dhe koston e implementimit.
2. Planifikimi i aktiviteteve bëhet sipas nevojave të identifikuara në terren dhe vjen nga:
 - 2.1. Iniciativa e ekipeve hulumtuese në kuadër të UP/FE;

- 2.2. Me kërkesë të MASHTI-t apo
- 2.3. Me kërkesë të ndonjë institucioni arsimor me qëllim të implementimit të ndryshimeve në arsim të bazuara në hulumtime/dëshmi.
3. Palët zotohen t'i zbatojnë obligimet e tyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje në pajtim me legjislacionin në fuqi. Palët përcjellin zbatimin e kësaj marrëveshje dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve që dalin nga kjo marrëveshje për periudhën e realizimit të kësaj marrëveshje.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Marrëveshja e bashkëpunimit shërben si marrëveshje e vullnetit të mirë mes të dy palëve për bashkëpunimin institucional me qëllim të përgatitjes dhe avancimit profesional, por nuk detyron ligjërisht asnjërën palë. Çdo mosmarrëveshje midis palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje do të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve të drejtpërdrejta.

Neni 6

Ndryshimet dhe Shkëputja e Marrëveshjes

1. Çdo ndryshim në këtë marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe me pëlqimin e ndërsjellë të dyja palëve.
2. Në rast të pamundësisë së tejkalimit të mosmarrëveshjeve, interpretimeve apo pikëpamjeve të ndryshme, palët nënshkruese të kësaj marrëveshje mund të kërkojnë anulimin e saj, bazuar në kërkesën me shkrim, me një paralajmërim me shkrim prej së paku 2 muajve.

Neni 7

Kostoja dhe detajet e implementimit

1. UP/FE dhe MASHTI në bazë të kësaj marrëveshje do të hartojnë një plan dinamik të implementimit që detajon aktivitetet në raport me resurset në dispozicion.
2. Së paku një herë në vit alokohen fondet e caktuara për implementim të aktiviteteve që realizohen në kuadër të kësaj marrëveshje në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
3. Fondet sipas pikës 2 të këtij transferohen në xhirollogarinë e Universitetit të Prishtinës i cili i dedikohet realizimit të aktiviteteve të dakorduara në mes palëve.
4. Fakulteti i Edukimit harton raport 6 mujor për implementim dhe raportim të shfrytëzimit të fondeve për këtë projekt për Universitetin dhe për MASHTI-n.

Neni 8

Ligji i aplikueshëm

1. Kjo Marrëveshje dhe të gjitha nenet e saj rregullohen dhe interpretohen në përputhje me Ligjin e Kosovës.